



Prishtinë, 19 prill 2018

## **Komunikatë për media**

### **ZRRE dhe Banka Botërore diskutojnë zhvillimet e sektorit të energjisë në sferën e Burimeve të Ripërtëritshme dhe Efiqencës së energjisë**

Përfaqësues të Zyrës së Rregullatorit për Energji (ZRRE) dhe Bankës Botërore (BB) kanë diskutuar dhe rreth zhvillimeve të deritanishme dhe ato që pritet të zhvillohen në sferën e Burimeve të Ripërtëritshme dhe atë të Efiqencës së energjisë. Me këtë rast Z. Selman Hoti, anëtar i Bordit të ZRRE ka falënderuar BB-së për mbështetjen e vazhdueshme që ka ofruar për Kosovën dhe në veçanti për ndihmën e ofruar ZRRE-së, përmes konsulencës teknike, që nga themelimi i saj e deri më sot. Përfaqësues të BB-së fillimisht kanë njoftuar ZRRE-në në lidhje mbarëvajtjen e Projektit të Efiqencës së Energjisë dhe Energjisë së Ripërtëritshme të Kosovës (KEEREP), projekt ky në një vlerë prej 31 milionë dollarësh dhe i cili synon të reduktojë konsumin e energjisë dhe përdorimin e lëndëve djegëse fosile në ndërtesat publike. Siç u tha nga përfaqësuesit e BB, pjesë e këtij projekti është edhe përmirësimi i politikës dhe mjedisit rregullator për energjinë e ripërtëritshme dhe efikasitetin e energjisë.



Takim në mes përfaqësuesve të ZRRE dhe BB

Me këtë rast ZRRE dhe BB diskutuan edhe për sferat në të cilat ekspertët e BB-së mund të ofrojnë këshillat e tyre në përmirësimin e ambientit rregullativ dhe procesit të lëshimit të Autorizimeve për ndërtimin e kapaciteteve të reja nga Burimet e Ripërtëritshme të Energjisë (BRE). ZRRE me këtë rast ka njoftuar me të arriturat e deritanishme në procesin e lëshimit të autorizimeve nga ZRRE për ndërtimet e kapaciteteve të reja të BRE-ve dhe ngecjet që janë vërejtur gjatë këtij procesi. Po ashtu ZRRE ka njoftuar BB me planet e saj për rishikimin e Skemës Mbështetëse, në favor të përmirësimit të ambientit rregullativ për investitorët e tanishëm dhe ata të rinj potencial, si dhe zhvillimin e procesit për lëshimin e Certifikatës së Origjinës për energjinë e prodhuar nga këto burime.